



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 15 datë 30/01/1998

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen dt.30.01.1998, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Zhvillimit Ekonomik në Bashki “Mbi bllokimin e qarkullimit të karrove tërhequr me kafshë” vëren se :

Lëvizja e karrove me kafshë në Tiranë është bërë fenomen tepër shqetësues për trafikun rrugor, duke sjellë pasoja negative jo vetëm për qarkullimin e automjeteve, por edhe për higjenën e pastërtinë e mjediseve në kryeqytet. Aktualisht është edhe një tendencë e shtimit të numrit të tyre dhe lëvizjes pa kriter në gjithë rrugët edhe brënda Unazës.

Për arsyet e mësipërme në kuadrin edhe të përmirësimit të trafikut rrugor dhe pamjes së kryeqytetit, në mbështetje të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin e funksionimin e pushtetit lokal”, neni.14, pika.8 e 11, ligjit “Për Rendin Publik”, neni.6, 8, 9, e 12, Këshillit Bashkiak Tiranë

**V E N D O S I**

1. Ndalimin tërësisht të qarkullimit të karrove të tërhequra me kafshë në qytetin e Tiranës, duke filluar nga data 1 prill 1998.
2. Nga Sektori i shtypit në Bashki të bëhet njoftimi përkatës në media, në mënyrë që personave që ushtrojnë këtë veprimtari tu bëhet e ditur zbatimi i vendimit për mundësinë që ato brënda 3 muajve të sistemohen në punë tjetër.
3. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Transportit të bashkëpunojnë ngushtë duke kordinuar punën me organet e policisë së Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në Bashkinë e Tiranës dhe Policia e Tiranës.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**